

VENDIM
Nr.75, datë 8.2.2006

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS ÇEKE, PËR NXITJEN DHE
MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE, NËNSHKRUAR NË PRAGË, MË 27
QERSHOR 1994**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 27 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e disa ndryshimeve, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi, në marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve, nënshkruar në Pragë, më 27 qershor 1994.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCË

Neni 3

Trajtimi kombëtar dhe i kombit më të favorizuar

Ministria e Financës së Republikës së Çekisë propozon heqjen e paragrafit 3, neni 3 i marrëveshjes dhe zëvendësimin e tij me paragrafët nga 3 në 5:

3. Dispozitat për trajtimin kombëtar dhe atë të kombit më të favorizuar në këtë nen nuk do të jenë të vlefshme për përfitimet e dhëna nga pala kontraktuese në përputhje me detyrimin e saj si anëtare e bashkimit doganor, ekonomik ose monetar, e një tregu të përbashkët ose e një zone të tregtisë së lirë.

4. Pala kontraktuese njeh detyrimet e palës tjetër kontraktuese si anëtare e bashkimit doganor, ekonomik dhe monetar, e një tregu të përbashkët ose e një zone të tregtisë së lirë, për përfshirjen e detyrimeve që rrjedhin nga një marrëveshje ndërkombëtare ose e anasjellë e atij bashkimi doganor, ekonomik e monetar, tregu të përbashkët ose një zone të tregtisë së lirë.

5. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk do të interpretohen mënyrë të tillë që të detyrojnë një palë kontraktuese, të shtrihet deri tek investitorët e palës tjetër kontraktuese ose tek investimet, të ardhurat e investitorëve të tjerë, përfitimet nga çdo trajtim, preferencë ose privilegj, të cilat mund të zbatohen nga pala kontraktuese duke u mbështetur në cilëndo marrëveshje ndërkombëtare që lidhet plotësisht ose kryesisht me taksat.

Neni6

Transfertat

Në përputhje me nenet 57.2, 59, 60.1 dhe 60.2 të Traktatit të formimit të Komunitetit European, Ministria e Financës së Republikës së Çekisë propozon përfshirjen e tekstit të mëposhtëm, lidhur me transfertat e pagesave të investitorëve ndaj një vendi të huaj, në fillimin e fjalisë së parë të paragrafit 1, neni6 i Marrëveshjes:

“Pa cenuar masat e miratuara nga Komuniteti European ose ato të marra nga pala kontraktuese për arsye të rëndësishme politike dhe në raste emergjente...”.

Neni 11

Interesat bazë të sigurisë

Në përputhje me nenet 60 dhe 301 të traktatit të formimit të Komunitetit Europian, Ministria e Financës së Republikës së Çekisë propozon që pas nenit 10 të përfshihet-zbatimi i normave dhe angazhimeve të tjera të veçanta, neni 11- interesat bazë të sigurisë.

“Asgjë e përcaktuar në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet në mënyrë të tillë që të pengojë ndonjërin prej palëve kontraktuese për marrjen e masave, të cilat konsiderohen si të nevojshme për mbrojtjen e interesave bazë të sigurisë:

- a) në lidhje me veprat penale;
- b) në lidhje me trafikun e armëve, municioneve dhe mjeteve të luftës, si dhe marrëveshjet për mallrat, materialet, shërbimet dhe teknologjinë e ndërmarrë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, me qëllim furnizimin e njësisë ushtarake ose të sigurisë;
- c) të ndërmarra në kohë lufte ose gjendje të jashtëzakonshme në marrëdhëniet ndërkombëtare; ose
- d) në lidhje me zbatimin e politikave kombëtare ose marrëveshjeve ndërkombëtare, duke respektuar mospërhapjen e armëve bërthamore ose mjeteve të tjera me shpërthim bërthamor; ose
- e) në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Karta e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.”.

2. Interesat bazë të sigurisë të një pale kontraktuese mund të përfshijnë edhe interesat që vijnë si rrjedhojë e anëtarësimit të saj në një bashkim doganor, ekonomik e monetar, në një treg të përbashkët ose një zonë të tregtisë të lirë.

Nenet pasuese të marrëveshjes do të rinumërohen.